

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

Për :	Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës Bexhet Kuçi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Emilija Redžepi, Ministre e MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL	Datë: 18/02 /2020 Nr. 020-89
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë e aktit të komunës së Suharekës	
Lloji i aktit:	Vendimit	

I/e nderuar Kryetar,  
I/e nderuar Kryesues,


Në pajtim me Rregullores e QRK-së Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregullores e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 80 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimit nr. 16-7828 për miratimin e nismës se kryetarit të komunës së Suharekës për të hyrë në bashkëpunim ndërkomunal me katër komuna të Republikës se Kosovës.

I miratuar më datë: 30.01.2020

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.01.2020

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



# Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za :	Bali Muharremaj, gradonačelnik Opštine Suva Reka Bexhet Kuçi, predsedavajući Skupštine opštine Suva Reka	
Cc:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Emilija Redžepi, ministarka MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a,	
Od:	Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština /MALS	Dana, 18.02.2020
Službenik za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odsjeka za monitorisanje opština	br. 020-89
Službenik za izradu:	Driton Xhafa, službenik za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Suva Reka	
Vrsta odluke:	Odluka Skupštine opštine	

Uvaženi gradonačelnice,

Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 02/2011 o oblastima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primio je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 80. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:


Odluka br. 16-7828 za odobravanje inicijative gradonačelnika opštine Suva Reka, kako bi započeli međuopštinsku saradnju sa četiri opština Republike Kosova.
Usvojena dana, 30.01.2020. godine,
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 31.01.2020. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa **zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi** i kao takav može proizvesti pravni učinak.

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
 REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
 KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË  
 MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË  
 SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Në bazë të nenëve 12, 17 lidhur me nenin 28 dhe 29, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", e në mbështetje të nenit 6, pika 2.1 lidhur me pikën 6, të Ligjit Nr-04/L-010 për bashkëpunim ndër-komunal, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-7/2011" dhe konformi nenit 5, paragrafi 1, pika 1.1 lidhur me nenin 6, të Rregullores Nr. 09/2013 për nënien e bashkëpunimit ndër komunal dhe nenëve 15, 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 30.01.2020, miraton këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1**

1.1 Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Suharekës për të hyrë në bashkëpunim ndër-komunal me Komunitet tjera të Republikës së Kosovës.


1.2 Bashkëpunimi ndër-komunal do të zhvillohet në mesë të Republikës së Kosovës si në vijim:

1.2.1 Komunës së Suharekës të Republikës së Kosovës

1.2.2 Komunës së Prizrenit të Republikës së Kosovës

1.2.3 Komunës së Dragashit të Republikës së Kosovës dhe

1.2.4 Komunës së Mamushes të Republikës së Kosovës



**Neni 2**

**AUTORIZOHET**, Kryetari i Komunës që të fillon konsultimet dhe bisedimet për hartimin e marrëveshjes për bashkëpunim ndër-komunal në mesë të Komunës së Suharekës të Republikës së Kosovës, Komunës së Prizrenit të Republikës së Kosovës, Komunës së Dragashit të Republikës së Kosovës dhe Komunës së Mamushes të Republikës së Kosovës dhe palët tjera të interesuara për bashkëpunim.

**Neni 3**

**OBLIGOHET**- Kryetari i Komunës që pas përfundimit të konsultimeve dhe në bazë të konsultimeve paraprake të përgatisin draft-marrëveshjen për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal në mesë 4, (katër) Komunave dhe atë në kundërt të kompetencave të tyre vetanake, financimin e "Qendrës për strehimin e grave dhe fëmijëve" dhe nënshkruhet nga Kryetaret e Komunave dhe miratohet nga Kuvendet Komunale të Komunave që janë pjesëmarrëse në bashkëpunimin ndër-komunal.


**Neni 4**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hën në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008"), nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr-10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimit e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelen e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË**

01-Nr- 046-2828

Më datë 30.01.2020



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI

## Driton Xhafa

---

**From:** Besa Shala  
**Sent:** Monday, February 10, 2020 2:55 PM  
**To:** Driton Xhafa  
**Cc:** Trim Berisha; Blerta Halimi; Rexhep Kelani  
**Subject:** FW: Vendimet e KK Suharekë  
**Attachments:** 020-89-2020.pdf; ATT00001.htm

Të nderuar/a,

Vendimi për miratimin e nismës të Kryetarit të Komunës së Suharekës për të hyrë në bashkëpunim me komunat: Prizren Dragash dhe Mamushë është konform Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal.  
Pasi kjo iniciativë përfshin bashkëpunimin e 4 komunave, të njëjtat procedura duhet të ndjekin edhe komunat tjera.

Me respekt,

### ***Besa Shala***

Zyrtare për promovimin e bashkëpunimit komunal  
Departamenti për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe Ndërkufitar  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
tel. 038/200 35 573  
Adresa: Ish pallati i shtypit "Rilindja"-Kat.11

---

**From:** Trim Berisha  
**Sent:** Monday, February 10, 2020 11:42 AM  
**To:** Blerta Halimi; Besa Shala  
**Subject:** Fwd: Vendimet e KK Suharekë

Shikojeni ju lutem, dhe përgatiteni një përgjigje.

Sent from my iPhone

Begin forwarded message:

**From:** Driton Xhafa <driton.xhafa@rks-gov.net>  
**Date:** February 10, 2020 at 11:40:13 GMT+1  
**To:** Trim Berisha <Trim.Berisha@rks-gov.net>  
**Cc:** Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>  
**Subject:** FW: Vendimet e KK Suharekë

I nderuar,

Bashkangjitur gjeni vendimin dhe për miratimin e nismës së kryetarit të komunës për të hyrë në bashkëpunim ndërkomunal me katër. Mirëpres mendimet e juaja, nëse është e mundur brenda ditës përgjigjen.